REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 21248 prot. Vlorë, më 22.10 2026

PROJEKTVENDIM

Nr._____datë._____2026

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SHTESË PËR FËMIJËT E FAMILJEVE QË KANË NEVOJË PËR KOPSHT DHE ÇERDHE FALAS

Këshilli i Bashkisë Vlorë, mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, neni 24 , neni 30 pika 7 dhe neni 54 pika k dhe n ,në Ligjin Nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republiken e Shqiperisë", neni 2 pika b dhe neni 6, ne Ligjin 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", VKB nr. 4 datë 30.01.2026 " Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën dhe nga fondet e Buxhetit Vendor", si dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, për Këshillin e Bashkise:

V E N D O S I:

1.Të frekuentojnë kopshtin me drekë 4 fëmijë.
2.Të frekuentojne çerdhen me drekë 2 femijë .
3.Frekuentimi i femijëve në këto institucione të trajtohen për një periudhë 3 mujore.
4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social .

	EMËR ATËSI MBIEMËR	Përshkrimi i gjendjes socio - ekonomike
1	Alesjo Kasaj	I mituri A.Kasaj, i datëlindjes 16.06.2021, me vendbanim në Vlorë. Familja përbëhet prej pesë personash dhe paraqet vështirësi socio-ekonomike. Kërkohet mbështetje për sigurimin e shërbimeve bazë për fëmijën, në mënyrë zhvillimin e tij social dhe edukativ.
2	Elumeda Ali	Lindur ne Vlorë më 09.02.2024 e bija e Eliona dhe Eduart Ali. Në kuadër të mbështetjes së familjes kërkohet mundësia e përfshirjes pa pagesë në kopësht, pasi familja paraqet vështirësi socio-ekonomike.
3	Dhurata Goxhaj	E mitura Dh.Goxhaj, e lindur më 18.10.2024, me vendbanim në Vlorë. E mitura jeton së bashku me nënën dhe gjyshërit, të cilët paraqesin vështirësi socio-ekonomike. Nëna e të miturës ka problematika shëndetësore. Sa më sipër kërkojmë mbështetjen e të miturës me frekuentim falas në një nga cerdhet të bashkisë Vlorë.
4	Erlind Kamberaj	I mituri E.Kamberaj, i lindur më 21.02.2023, me vendbanim në Vlorë. Familja e të miturit përbëhet prej 5 personash, 3 fëmijët dhe bashkëshortët. Familja ka vështirësi ekonomike dhe informojnë se i mituri i moshës 3 vjec ka diagnozë "Prapambetje Mendore". Aktualisht frektuenton kopshtin nr.2 dhe është në pritje të mësueses ndihmëse. Kërkohet mbështetje për frekuentim pa pagesë të kopshtit.
5	Cem Hyseni	I lindur më 24.07.2021, me vendbanim në Vlorë. Jeton së bashku me prindërit dhe vëllanë më të vogël. Aktualisht frekuenton kopshtin nr.13, por familja ka vështirësi ekonomike dhe prindërit e papunë. Nëna nuk punon sepse kujdeset për fëmijët, kurse babai nuk ka punë stabël. Kërkohet mbështetje për frekuentim pa pagesë të kopshtit.
6	Gloen Hyseni	I lindur më 17.01.2024, me vendbanim në Vlorë. Jeton së bashku me prindërit dhe vëllanë më të madh. Aktualisht frekuenton kopshtin nr.13, por familja ka vështirësi ekonomike dhe

		prindërit e papunë. Nëna nuk punon sepse kujdeset për fëmijët, kurse babai nuk ka punë stabël. Kërkohet mbështetje për frekuentim pa pagesë të kopshtit.

5. Fondet per financimin e shpenzimeve per ushqimin e femijeve do te perballohen nga Buxheti i vitit 2026 miratuar me VKM Nr. 100 datë 23.12.2025 i ndryshuar.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b .

KRYETAR

Brunilda Mersini

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 3128 prot. Vlorë, më 22.10.2026

RELACION

mbi

Miratimin e listës për fëmijët e familjeve që kanë nevojë për kopësht dhe çerdhe.

Gjatë punes se njësise se Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave në muajin Shtator 2026 janë evidentuar rreth 6 familje në kushte shumë të vështira socio-ekonomike. Si pasojë mendojmë të fuqizojmë këto familje dhe për mbështetjen e tyre, propozojmë që të kemi një listë shtesë prej 6 femijesh. Konkretisht 4 femijë ne kopësht dhe 2 në cerdhe nga . Kjo listë shtesë i shtohet listës prej 19 fëmijesh që janë në projektventdimin e viti 2026 për cerdhe dhe kopësht falas.

Konceptoi: LMuharemi

Drejtor i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social

Uljana Hënaj

Adresa:Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033421222; Fax 033421222: www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al